

Alketa Vejseli, që prej gushtit 2024 mban rolin e Drejtorit në Drejtorinë Çështjeve të Tregtisë së Jashtme në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ku kontribuon në hartimin e politikave për liberalizimin e tregtisë, duke u fokusuar në përputhshmërinë me marrëveshjet ndërkombëtare dhe shumëpalëshe në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) dhe marrëveshjeve dypalëshe të tregtisë së lirë.

Në tetor 2020 deri më 2024, ajo ka mbajtur rolin si Përgjegjëse e Sektorit të Çështjeve të Tregtisë dhe më pas si Përgjegjëse e Sektorit të Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë dhe Politikave Tregtare, gjithashtu në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Gjatë kësaj periudhe, Alketa ka mbikëqyrur zbatimin e marrëveshjeve të tregtisë së lirë, veçanërisht Marrëveshjen Rajonale CEFTA, dhe ka koordinuar me institucionet përkatëse për të siguruar zbatimin e Planit të Veprimit për Krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal.

Ka një përvojë të pasur pune në sektorin publik, duke punuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë që nga viti 1994. Gjatë kësaj periudhe, ajo ka mbajtur pozita të ndryshme, duke filluar si Specialiste për financë në Sekretarinë Ekzekutive të Bankës Botërore dhe më pas si Specialiste e Prokurimeve. Në vitet e mëpasshme, ajo është angazhuar si Përgjegjëse e sektorit IPARD në Zyra Mbështetëse të Zyrtarit Kombëtar Autorizues, ku ka supervizuar sistemin e kontrollit të brendshëm dhe ka garantuar ligjshmërinë dhe rregullsisë së transaksioneve në Programin IPARD.

Alketa është e njohur për kontributet e saj në hartimin e marrëveshjeve dypalëshe për bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar, duke ndjekur gjithashtu zbatimin e këtyre marrëveshjeve dhe protokolleve bilaterale. Ajo ka pasur rol të rëndësishëm në negociatat për anëtarësimin e Shqipërisë në OBT dhe ka ndihmuar në analizën e legjislacionit tregtar dhe përgatitjen e materialeve të negociimit për marrëveshjet me Bashkimin Evropian.